

PROTOKOLL

ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë – Drejtorisë së Përgjithshme të
Doganave të Republikës së Shqipërisë

dhe

Ministrisë së Financave – Administratës Doganore të Republikës së Maqedonisë
së Veriut

në lidhje me zbatimin e

Marrëveshjes për njohjen e ndërsjellë të operatorëve ekonomikë të autorizuar –
autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS) ndërmjet Këshillit të Ministrave
të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në përputhje me nenet 8 dhe 11 të marrëveshjes për njohjen e ndërsjellë të operatorëve
ekonomikë të autorizuar – autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS) ndërmjet
Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së
Maqedonisë së Veriut, nënshkruar më 21 dhjetor 2021 në Tiranë, Ministria e Financave
dhe Ekonomisë – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Republikës së Shqipërisë dhe
Ministria e Financave – Administrata Doganore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
(në vijim referuar si "Palët").
bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Dispozitat hyrëse

Ky Protokoll përcakton metodën e kryerjes së procesit të vlefësimit të njohjes së
ndërsjellë të OEAS.

Neni 2

Ekipi i vlefësimit

Secila Palë i njofton Palës tjetër me shkrim anëtarët e ekipit të saj të vlefësimit. Ekipi
i vlefësimit i secilës Palë përbëhet nga ekspertë të OEA, me nga tre anëtarë secili.

Neni 3

Procesi i vlefësimit

Palët bien dakord për datën e saktë të fillimit të vlefësimit.

Përpara vizitës së planifikuar të ekipit të vlefësimit, Palët shkëmbejnë me njëra-tjetrën
dokumentacionin e plotë në lidhje me Programin e OEA në gjuhët zyrtare të Palëve dhe
në gjuhën angleze. Dokumentacioni që duhet shkëmbyer përfshin: dispozitat e

legjislacioni doganor në lidhje me OEA, dispozitat e akteve nënfigjore përkatëse, shpjegime dhe udhëzime.

Përpara kryerjes së një vizite pranë një shoqërie, duhet të merret pëlqimi i shoqërisë përkatëse për vizitën e delegacionit të huaj.

Ekipet e vlefësimit do të vizitojnë dy shoqëri të pajisura me autorizimin e OEA.

Në vijim të vizitës do të hartohet një raport, ku anëtarët e ekipit do të japin opinionet e tyre lidhur me programin e OEA, duke përfshirë gjykimin e tyre nëse programi është zbatuar në përputhje me kushtet e parashikuara.

Neni 4 Rezultatet e vlefësimit

Për kërkesat e këtij Protokollit, Palët bien dakord të njohin Raportin e Vlefësimit të Njohjes së Ndërsjellë të OEAS për Programin e OEA dhe proceset e OEA, i cili është ekuivalent me të njëjtin proces vlefësimi të kryer ndërmjet vetë Palëve, dhe është hartuar nga ekipi i vlefësimit i emëruar nga Sekretariati i CEFTA.

Neni 5 Shkëmbimi i informacionit midis Palëve

Shkëmbimi i informacioneve të parashikuara në nenin 8 të marrëveshjes për njohjen e ndërsjellë të operatorëve ekonomikë të autorizuar – autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut bëhet çdo javë nëpërmjet Sistemit të Shkëmbimit Sistematik Elektronik të të Dhënave (SEED).

Neni 6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Protokollit do të zgjidhet, sipas rastit, në nivelin e ekipeve të vlefësimit.

Mosmarrëveshjet për të cilat nuk arrihet një zgjidhje sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni do t'u referohen autoriteteve më të larta të secilës Palë.

Neni 7 Hyrja në fuqi dhe periudha e vlefshmërisë së Protokollit


Ky Protokoll hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga të dyja Palët.

Vlefshmëria e këtij Protokollit përfundon në datën kur të dyja Palët janë njoftuar për përfundimin e procesit të vlefësimit.

NËNSHKRUAR në Skutip, më 14.06.2012. Në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, maqedonase, dhe angleze, ku secili tekst ka të njëjtën vlerë ligjore. Në rast mosmarrëveshjes në lidhje me interpretimin, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

Për


Ministrinë e Financave dhe
Ekonomisë Republikës së Shqipërisë


DELINA IBRAHIMAJ

Ministër

Për

Ministrinë e Financave
të Republikës së Maqedonisë së
Veriut


FATMIR BESIMI

Ministër